

Perandoria Ruse

Elena Marushiakova
Veselin Popov

Romët në Ukrainë | Qëllimet strategjike të politikës shtetërore ndaj “ciganëve” | Realizimi praktik i politikës shtetërore | Romët në territoret e reja | Krimea dhe Rusia jugore | Bessarabia | Faraonovka dhe Kair | Bujkrobërit “ciganë” | “Ciganët” pas reformës së vitit 1861

➤ *Perandoria Ruse ka ushtruar ndikimin e saj ndaj shumë popujve. Ndryshe nga vendet tjera në Evropë, politika shtetërore e Perandorisë Ruse ndaj romëve fillimisht dhe për një kohë të gjatë i trajtoi ata si subjekte të barabarta të Perandorisë me të drejta të plota civile. Përpjekjet administrative të shtetit kishin për qëllim t’i bënin romët që t’i përmbushnin obligimet e tyre si qytetarë. Kjo politikë mbi të gjitha ishte një politikë “mbizotëruese”; “Ciganët” konsideroheshin si një pjesë e pandarë e shoqërisë, dhe në këtë mënyrë i nënshtroheshin legjislacionit të përgjithshëm. Në rastet ku ekzistonte një politikë “speciale” e drejtuar nga ta, qëllimi ishte që të tejkalohesh ndarja nga shoqëria, pa ushtruar presion drejt asimilimit të tyre.*


PERANDORIA RUSE

Perandoria ruse u rrit nga e ashtuquajtura Rusia Muskovite, e cila nga shekulli i 15-të (e veçanërisht pas shpalljes së Ivanit IV Car të Tmerrshëm në vitin 1547) e më tej filloi të zhvillohej në mënyrë rapide dhe të zgjerohet, duke shtuar territore dhe popullsinë e tyre gjithnjë e më shumë në Perandori. Edhe pse formalisht Rusia ishte perandori vetëm prej vitit 1721 (sundimi i Peter I i Madh) e më tej, ky emër i përgjithësuar gjithashtu mund të përdorej për periudhat e mëhershme. Romët, të cilët kishin jetuar me shekuj në Perandorinë Ruse, ishin të ndikuar në masë të madhe nga kushtet mbizotëruese shoqërore dhe politike, dhe kjo pasqyrohet në karakteristikat e tyre bashkëkohore etnike dhe kulturore.

III. 2

HYRJE


Një kartë e datës 1501 mund të konsiderohet si dëshmi e parë e arritjes së romëve në Perandorinë Ruse. Në këtë dokument Alexander Kazimirovich, Princ i Dukatit të Lituanisë dhe Mbreti i Polonisë i lejoi “të Moshuarit voyt Vassil dhe Ciganëve të tij” liri të plotë të udhëtimit në tokat e dukatit dhe i dha udhëheqësit të tyre të drejtën “t’i gjykoj Ciganët dhe të zgjidh mosmarrëveshjet



në mes tyre”. Nëse këto territore, që vetëm më vonë i ishin shtuar Perandorisë Ruse, do të mund të quheshin si pjesë e Perandorisë Ruse, është temë diskutimi.

Me siguri “Ciganët” në Perandorinë Ruse përmenden për herë të parë në vitin 1733 në një dekret të lëshuar nga Perandoresha Anna Ioanovna, që kishte të bëjë me vendosjen e pensionit të vjetër të tri regjimenteve përmes taksave, të mbledhura nga popullata e

disa territoreve, përfshirë “Ciganët”. Jo shumë më vonë një dekret u miratua nga Senati i Shën Petersburgut si përgjigje ndaj peticioinit të “Ciganëve, të lindur në këto treva”, që iu mundësonte atyre të jetojnë dhe të bëjnë tregti me kuaj në zonën përreth kryeqytetit Shën Petersburg, me obligimin për të regjistruar “çkado që dëshirojnë”. Pasuri “të lindur në këto treva” i referohet një vendosjeje të mëhershme të romëve në Perandorinë Ruse. [Iills. 1-4]



III. 4

Periudha e parë e imigrimit në Perandorinë Ruse i gjeti "Ciganët" duke lëvizur nga jugu për në Ukrainë dhe nga lindja në Bjellorusi dhe vendet baltike në shekujt 15-të dhe 16-të. Sot, këta imigrantë të hershëm njihen si "Xaladitka" ose "Ruska Roma", afërsisht të lidhur "Polska Roma" (gjithashtu të quajtur "Xaladitka Roma") në Lituani dhe Poloninë e sotme, dhe "Litovska Roma" në Lituani dhe Bjellorusi. "Lotfika" romët (letonez) në regjionin e Baltikut gjithashtu janë të afërt me ta. Për shembull, "Servi/Servuria", u vendosën në Ukrainën lindore dhe Rusinë jugore në mesin e shekullit të 16-të pas imigrimit nga Wallachia dhe Moldavia.

ROMËT NË UKRAINË

Burimet e para të shkruara që përmendnin "Ciganët" në territoret e sotshme të Ukrainës datojnë që nga shekulli i 15-të, për shembull disa shënime të pakta për "Ciganët" në regjistrat e qytezave të Sanok dhe Lvov për periudhën 1427/28-1445. Gjatë shekujve 16-të -18-të prania e romëve ka lënë gjurmë në dokumentet nga "Slobozhanshchina" Ukrainase (territoret në bregun e majtë të Dnjeprit) dhe "Zaporozhskaya Sech" autonome (e Kozakëve të ashtuquajtur Zaporozhian). Në regjistrat e tërë armatës Zaporozhian gjejmë emra të tillë si Vasko Tsigan, Stepan Tsiganchuk, Dmitro Tsiganchuk (nga "Tsigan", rusisht për "Cigan"). Romët kryesisht shërbenin si farkëtar dhe armëpunues në regjimentet e ushtrisë.

Pas vitit 1654 Ukraina iu bashkua vullnetarisht Perandorisë Ruse, por që prapë mbante një autonomi të caktuar të brendshme. "Ciganët" përfshiheshin në regjistrat e ndarë të taksave, të ndarë në "regjimente", të udhëhequr nga "atamanët" (prijësit) e tyre, të cilët ishin propozuar nga vetë "Ciganët" për këto pozita para emërimit të tyre. Kjo nuk duhet të kuptohet në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës; romët në Ukrainë nuk shërbenin në ushtri në mënyrë aktive. Në fakt atë që dokumente tregojnë është se romët

ishin përfshirë në organizimin ekzistues ushtarak dhe administrativ të asaj kohe. Obligimi kryesor i "atamanëve" "Ciganë" ishte të mblidhnin taksën vjetore ("obrok") së bashku me grumbulluesit e emëruar të taksave (të cilët kishin blerë të drejtën për grumbullin e taksave në një ankand) dhe ta paraqitnin atë para zyrës së përgjithshme ushtarake për mirëmbajtje të ushtrisë. Emërimi i "atamanëve" "Ciganë" ishte përcaktuar nga shteti duke paguar një shumë të caktuar të parave. Taksa vjetore e "Ciganëve" u rrit gjatë viteve, që është dëshmi e ngritjes së mirëqenies së tyre – në fillim të shekullit të 18-të arrinte shumën deri në 120 "karbovantsi" (valutë ukrainase) në vit ndërsa në vitin 1755 arriti shumë prej 1,424 "karbovantsi".

Regjimentet speciale të "Ciganëve" u shfuqizuan në vitin 1765 dhe romët pastaj u regjistruan në "sotni" (skuadrone kozake) ekzistuese dhe regjimente, kështu që kishin të drejtat civile sikurse pjesa tjetër e popullsisë. Të gjitha çështjet e "Ciganëve" i nënshtroheshin Komisionit Civil-Ushtarak të Kievit, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhte regjistrimin e tyre të obligueshëm me kërkesat për vendbanim të përhershëm. Sidoqoftë, këto masa nuk e bënë të pamundur për romët që të jetonin një jetë gjysmë-nomade (me banim të caktuar dimëror) ose nomade. Profesionet e tyre kryesore ishin llojet e ndryshme të

prodhimit të hekurit, tregtisë me kuaj dhe interpretimit muzikor.

QËLLIMET STRATEGJIKE TË POLITIKËS SHTETËRORE NDAJ "CIGANËVE"

Relativisht pas një kohe të shkurtë të vendosjes së "Ciganëve" në Perandorinë Ruse u ndërmorën masa speciale ndaj tyre. Në vitin 1759 Perandoresha Elisabeth nxori një dekret me të cilin ndalohej udhëtimi i "Ciganëve" në kryeqytetin Shën Petersburg dhe përreth. Sidoqoftë, kjo nënkuptonte që atyre u ndalohej vendosja në kryeqytet. Në vitin 1766 një dekret i senatit rregullonte pagimin e taksave nga "Ciganët" nomadë në Perandorinë Ruse, të cilët kryesisht jetonin në të ashtuquajturën Slobodska Ukraina dhe në zonat përreth Moskës dhe qyteteve tjera kryesore në Perandori.

Romët më në fund u përfshinë në strukturën sociale të Perandorisë Ruse dhe morën të drejtat e tyre përkatëse civile përmes një dekreti të nxjerrë nga Katarina II e Madhe në vitin 1783. Sipas këtij dekreti të gjithë "Ciganët", të cilët ende nuk ishin regjistruar në Regjistrat Shtetërorë të Popullsisë, së bashku me ata që ishin të regjistruar në regjistra si prona (bujkrobër) të pronarëve të tokave bënin pjesë në kategorinë e të ashtuquajturve bujkrobër të shtetit dhe ishin të

III. 5

Gruaja e Johan Dimitri Taikon, tregimtare e famshme, si nuse e posa martuar në Rusi rreth vitit 1900. Familja Taikon lëvizën nga Rusia për në Suedi në atë kohë.


(nga Lundgren / Taikon 2003, f. 45)



III. 6

“Një udhëheqës Cigan” i Rusisë në shekullin e 19-të.
(extrait de Clébert, Jean Paul (nga Clébert, Jean Paul (1964) Das Volk der Zigeuner.

Wien: Paul Neff, f. 64b)



obliguar të paguanin taksat përkatëse për këtë kategori.

Dekreti i Katerinës II në fakt paraqet një qasje të re ndaj “Ciganëve” – fundi i politikës “speciale” shtetërore ndaj tyre dhe përfshirja e tyre në normat ligjore që mbizotëronin. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se ishte një përpjekje për t’i shtyrë romët të vendoseshin. Dekreti trajton statusin e fshatarëve shtetëror si një tërësi dhe pasqyron qëllimin e shtetit të grumbullojë taksat nga ata. Dekreti flet për “Ciganët” e vendosur në “vende të përshtatshme”, me sqarim “në mënyrë që ata të mos bredhin”, që do të thotë të mbahet një regjistrim i rregullt dhe të përmbushen kërkesat ligjore. Fshatarët shtetëror dhe bujkrobërit kishin të drejtë të udhëtonin lirisht, duke paguar një taksë të veçantë vjetore (“obrok”).

Kategoria e “fshatarëve shtetëror” mbi të gjitha përfshinte tërë popullatën ortodokse sllavo-folëse të territoreve rishitas të fituara – Siberia, Ukraina e bregut të majtë, Novorossiia, etj, së bashku me llojet e ndryshme të Kozakëve (Kozakët nga Don, Kuban, Ural, etj.). Në strukturën e ndërlikuar dhe burokratike shoqërore dhe pronësore të Perandorisë Ruse, fshatarët shtetëror kishin një status më të mirë se bujkrobërit.

Bujkrobëria në anën tjetër ofronte mundësinë për t’iu paguar “obrokun” vjetor zotërinjve të tokave, për të fituar të drejtën e lirisë së lëvizjes.

Para se të përfshiheshin në kategorinë e “fshatarëve shtetëror” romët përfituan nga kjo mundësi dhe vazhduan mënyrën nomade të jetesës, formalisht duke lëvizur nga një pronar i tokës në tjetrin (duke iu paguar për lirinë e lëvizjes). Me dekretin e saj Katerina e Madhe në fakt kishte qëllimin e ndërprerjes së kësaj praktike.

REALIZIMI PRAKTIK I POLITIKËS SHTETËRORE

Ndryshe nga shumë vende tjera, “Ciganët” në Perandorinë Ruse nuk ishin konsideruar si një “problem”, prandaj edhe rezultati i politikës shtetërore, që inkurajonte (por nuk zbatoi) vendosjen e tyre, ishte domethënëse. Në fakt, kjo politikë rezultoi në një obligim për romët që të regjistroheshin në regjistrat administrativ dhe rregullisht të paguanin taksat e tyre, që (së paku formalisht) kërkonin një vendbanim të caktuar. Për më tepër ishte një dëshirë (por që nuk ishte e obligueshme) të ndërpritej (ose së paku të kufizohej) mënyra nomade e tyre e jetesës.

Kjo është vija e të gjitha masave shtetërore që pasuan dekretin e vitit 1783. Në vitin 1800, një dekret i senatit shpalli që regjistrimi i “Ciganëve” në regjistrat e taksave duhej të realizohej sa më shpejt që ishte e mundur. Dekreti

përmend se në disa “guberniyas” (distrikte) “Ciganët” janë vendosur në fshatra dhe shfrytëzohen për bujqësi, dhe se gjetiu ata janë vendosur në qyteza, janë regjistruar si tregtarë dhe si “meshchane” (pronarë të vegjël dhe zejtarë). Për më tepër dekreti thotë se kjo nuk konsiderohet shkelje e ligjeve, me kusht që ata paguajnë rregullisht taksat e tyre.

Procesi i regjistrimit të obligueshëm civil dhe (mbi të gjitha) të taksave për romët me sa duket kishte shkuar ngadalë që ilustron me një numër të letrave të Qeverisë nga fillimi i shekullit të 19-të, për shembull dekretet e Aleksandrit I prej vitit 1803 deri 1809. Në vitin 1811, Aleksandri I nxori një dekret për të plotësuar alokimin e “Ciganëve” në prona të ndara, dhe për të konfirmuar të drejtat e tyre të regjistrohen në pronën që ata dëshironin, përfshirë qytezat, me kusht që ata do të kryenin obligimet përkatëse civile deri në vitin 1812.

Në vitin 1839 një dekret i ri obligonte të gjithë “Ciganët” nomadë pa ndonjë vendbanim të caktuar, të regjistroheshin si fshatarë shtetëror deri me 1 janar, 1841. Me këtë hap romët u futën nën juridiksionin e Ministrisë së Punëve Shtetërore, e cila ishte përgjegjëse për reformimin e situatës së fshatarëve shtetëror.

Qasja e re ndaj “Ciganëve”, që kishte për qëllim në shfuqizimin e plotë të dallimeve në statusin e tyre shoqëror

Romët në territoret e reja

Krimea dhe Rusia jugore

Bessarabia

Faraonovka dhe Kair

ZEJET DHE ZANATET

III. 7

Zanatet dhe mënyra e jetesës së bujkrobërve “Ciganë”-relativisht ndryshojnë. Shumica që formalisht ishin “dvorovie” (që do të thotë bujkrobër shtëpiak) ishin zejtar efektiv nomadë. Ata paguanin “obrok” –un e tyre vjetor dhe udhëtonin lirshëm jo vetëm në Bessarabia, por gjithashtu përtej

kufijve të regjionit, duke shitur të mirat e tyre dhe ofruar shërbimet e tyre. Kjo mënyrë e jetesës do të mund të shpjegonte faktin se numri goxha i madh prej 100 farkëtarëve, 185 chobotari (krijuesit e një lloji të këpucëve për fshatarët), 46 kazanpunues, 7 argjendarë, 1 rrobaqepës, 1 berber, dhe 185 muzikantë dhe familjet e tyre jetonin në pronën e Princit Kantakusin afër fshatit të Markoutsit, afër qytezës Khotin.

KOLONIZIMI I STEPAVE:

RASTI I FARAONOVKA DHE KAIR

III. 8

Shpesh bëhet një analogji në mes të krijimit të dy fshatrave rome Faraonovka dhe Kair dhe politikës shtetërore të Perandorisë Austro-Hungareze dhe Spanjës ndaj romëve gjatë shekullit të 18-të dhe 19-të. Sidoqoftë, ekzistojnë dallime thelbësore, që e bëjnë këtë analogji të pabazë. Dallimi kryesor në Faraonovka dhe Kair ishte fakti se “Ciganët” nuk i nënshtroheshin ndonjë politike speciale, por ata shiheshin në kontekstin e policisë së Perando-

risë Ruse në regjion. Krijimi i fshatrave rome nuk ishte një veprim i zbatimit, por ishte pasoja e drejtpërdrejtë e parimit kryesor të politikës shtetërore për kolonizimin e regjioneve stepore, ku shumë vendbanime të reja ishin themeluar sipas parimit të etnisë. Kalimi drejt mënyrës së vendosur të jetës ishte vullnetarë. Nuk ishin marrë masa përkatëse kundër romëve, sikurse ishte rasti me Perandorinë Austro-Hungareze dhe Spanjën. Në terminologjinë bashkëkohore, në Faraonovka dhe Kair nuk kishte ndonjë vendosje dhe ndarje e detyruar, por më saktë një diskriminim pozitiv.

në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë, gjithashtu gjendet në dekretin e vitit 1856 (koha e luftës Krimeane), kur “Ciganët” u detyruan të shërbenin në rangje “së bashku me anëtarët tjerë të pronave që ata iu përkisnin”. Në fakt kjo nënkuptonte që deri në atë moment “Ciganët” kishin qenë të privilegjuar sepse ata kishin qenë të liruar nga shërbimi ushtarak.

ROMËT NË TERRITORET E REJA

Zgjidhja e përgjithshme e statusit civil të romëve në Perandorinë Ruse gjatë pjesës së dytë të shekullit të 18-të dhe pjesës së parë të shekullit të 19-të u komplikua me faktin se kjo ishte gjithashtu periudha e zgjerimit aktiv të perandorisë përmes shtimit të territoreve të reja. Disa nga këto, për shembull stepet e Rusisë jugore dhe Ukrainës jugore, ishin rrallë të banuara, por të tjerat (Krimea dhe Besarabia) kishin romët e tyre lokal, statusi i të cilëve duhej të rregullohej ligjërisht sipas legjislacionit të Perandorisë Ruse.

Në një varg të luftërave kundër Perandorisë Otomane, prej vitit 1774 deri 1812 Perandoria Ruse shtoi disa

territore, siç ishin Khaganati Krimean (i aneksuar si territor rus i njohur si Taurida Guberniya), territoret në mes të lumenjve Bug dhe Dniester, dhe territoret në mes të Dniester dhe Prut, atëherë të njohura si Besarabia (përfshirë regjionin e sotshëm të Besarabia në Ukrainë dhe Republikën e Moldovas). Territoret e reja u bënë baza e provincave të reja (Novorussia, Taurida, më vonë Besarabia), dhe shumë shpejt një popullatë e re filloi të vendoset në këto toka.

KRIMEA DHE RUSIA JUGORE

Romët në siujdhesën e Krimeas me popullsi relativisht të dendur shumë shpejt u inkorporuan në strukturën e re sociale dhe civile të Perandorisë Ruse. Në vitin 1812 një taksë vjetore prej 2 rublave për kokë banori ishte fikse për “Ciganët” e provincës së Tauridas (Krimea) si fshatarë shtetëror. Përveç kësaj, ata kishin mundësi të regjistroheshin në regjistrin e taksave në regjimente Kozake të ushtrisë kozake të Detit të Zi. Në vitin 1852 të gjithë “Ciganët” e gubernisë së Tauridas, të cilët ende nuk ishin regjistruar në regjistrin ushtarak, ishin të obligu-

ar të paguanin taksën ushtarake “se bashku me pronat tjera të mbetura”.


Për Krimeën ishte specifik fakti se një pjesë e pamasë e romëve që kishin statusin e fshatarëve shtetëror, ishin në fakt banor urban. Kjo ishte për faktin se pjesa veriore – stepa – e siujdhesës ishte rrallë e banuar dhe vetëm gradualisht kolonistët e origjinave të ndryshme etnike vendoseshin aty. Një pjesë e romëve ishin vendosur në qyteza, por madje edhe romët shëtitës kalonin dimrin në qyteza, dhe kalonin vetëm periudha të shkurta ose të gjata duke udhëtuar në sezonin e ngrohtë.

Një veçanti tjetër e romëve krimean ishte fakti që shumica e tyre ishin mysliman, dhe se shumica e tyre kishin humbur gjuhën e tyre dhe ishin bërë Tataro-folës. Në fakt atyre mund t'u atribuohen dy statuse civile – edhe si “Ciganë” edhe si Tatarë. Për këtë shkak në vitin 1855, në kulm të luftës Krimeane, kur ekzistonte një ndjenë e fortë anti-Ruse në mesin e popullsisë Tatarë, romët Krimean që kishin statusin e fshatarëve shtetëror, por që gjithashtu ishin anëtarë të komunitetit Tatar (që do të thotë se ishin folës Tatar dhe myslimanë), ishin të liruar nga ai status dhe ishin të obliguar të përmbushnin obligimet e tjera sikurse Tatarët.

VENDOSJA DHE PRIVILEGJET

III. 9

Gjatë pjesës së parë të shekullit të 19-të romëve u ishte dhënë e drejta për tu vendosur në regjionet stepore përreth lumit Kuban dhe Kaukazit verior. Kjo shoqërohej me privilegjet shtesë që u dhanë romëve. Në vitin 1832, 54 romë nga Pyatigorsk në Kaukazin verior ishin të lirë nga shërbimet ushtarake dhe nga taksat për 5 vite. Taksat që veçse i kishin paguar ishin kompensuar, pasi që ishin sulmuar nga “banditët përtej Kubanit” (që do të thotë nga popuj të ndryshëm të Kaukazit – Kerkazian, Çeçen, etj.), dhe ishin plaçkitur si dhe kishin pësuar dëme në shumë prej 13,659 rublave dhe 50 kopekë, një shumë substanciale për ato kohë; 6 njerëz ishin vrarë dhe 22 ishin kidnapuar. Në vitin 1838 edhe 27 familje rome, që jetonin në guberninë e Stavropolit ishin liruar nga shërbimi ushtarak për 5 vjet tjera (ata tanimë ishin liruar nga shërbimi në vitin 1832, kur ata u përfshinë në regjimentet lokale Kozake).



BESSARABIA

Situata e romëve në Bessarabia (tokat në mes të Dniester dhe Prut) ishte goxha ndryshe nga pjesët tjera të Perandorisë Ruse. Shumica e tyre fillimisht ranë nën sundimin e Principatës së Moldavisë, ku romët jetuan në statusin e sklllevërve. Regjioni i Budzhakut, i banuar nga Nogay Tatarët ndodhet në mes të grykëderdhjes së Danubit dhe Dniesterit. Pas vitit 1812, Nogay Tatarët nga Budzhak ishin zhvendosur në Krimea dhe filluan të përdorin stepet. Romët e Bessarabia kishin mundësinë të integroheshin në strukturën sociale të Perandorisë Ruse në mënyra të ndryshme dhe në një masë të madhe ata ishin të lirë të zgjedhin se si të integrohen vetvetiu. [III. 10]

Në vitin 1818, u miratua një Statut i Përkohshëm për Bessarabinë që trajtonte situatën e veçantë të “Ciganëve” në regjion. Romët ishin ndarë në dy kategori kryesore, njëra direkt nën sundimin e shtetit (ish “sklllevërit e princit”, apo “sklllevërit e Mbretërisë”), ndërsatë tjerët i përkisnin manastireve dhe personave privat (ish “sklllevërit e manastireve” dhe “sklllevërit e fisnikërisë”).

Për romët që më parë kishin qenë “sklllevër të princit”, në vitin 1818 u kri-

jua një institucion i ndarë në Qeverinë Regjionale të Bessarabisë, që do të thotë Zyra e Ciganëve të Mbretit, që duhej të regjistronte atasi “fshatarë shtetëror”, pavarësisht nga mënyra e tyre e jetesës (nomade ose të vendosur). Zyra e regjistrimit kishte përgjegjësi për “Ciganët” të cilët kishin ikur nga pronarët e tyre (fisnikët apo manastiret) në Bessarabia ose që kishin migruar nga Principatat e Wallachia dhe Moldavia. Zyra e Ciganëve të Mbretërisë tentoi të rregulloj udhëtimin e “Ciganëve” duke bërë dallime në mes të disa kategorive të romëve nomadë (Laeshi, Lingurari, Ursari). Pavarësisht nëse ata ishin vendosur ose jetonin një jetë nomade, “Ciganët e Mbretit” ishin të obliguar të paguanin taksën për kokë banori, që paguhej nga secila familje rome, e që ishte 10 rubla nga fillimi i viteve 1830-ta e më tej.

Në Bessarabia format e autonomisë për komunitetet rome gjithashtu ruheshin sikurse në Principatat e Wallachia dhe Moldavia. Direkt nën Zyrën e Ciganëve të Mbretërisë ishin të ashtuquajturit “buluk-bashi” dhe “judi”, të propozuar nga vetë “Ciganët”, që ishin përgjegjës për mbledhjen e taksave. Ata gëzonin disa privilegje të taksave dhe mund të vepronin si ndërmjetësues në konfliktet në mes “Ciganëve”, që do të

thotë se ekzistonte një autonomi e caktuar gjyqësore në komunitet.

FARAONOVKA DHE KAIR

Qëllimi i administratës në Bessarabia për të siguruar një regjistrim më të shpejt të romëve në një status më të lartë civil të fshatarëve shtetëror ishte drejtpërdrejt i lidhur me politikën e rikthimit të tokave stepore në pjesën jugore të regjionit të Budzhakut. Gjatë realizimit të kësaj politike në vitin 1826 “Ciganët e Mbretërisë” kishin mundësinë të zgjidhnin cilën mënyrë të jetesës ata dëshironin ta jetonin (nomade ose të vendosur), si dhe vendbanimin e tyre (në qyteza, në vendbanimet e kolonistëve shtetëror, ose në vendbanimet e reja që romët do të mund të ndërtonin vetvetiu në jug).

Vendbanimet e para të romëve në stepet e Budzhakut u ndërtuan në vitin 1829 dhe në vitin 1831 u ndërtuan dy fshatra të reja, të banuara nga romët Lingurari– Faraonovka (164 familje) dhe Kair (170 familje) – në “uyesd” Akerman (njësi administrative). Emrat e fshatrave u zgjedhën nga autoritetet, bazuar në mendimin e atëhershëm do-

KORET E ROMËVE DHE ARISTOKRACIA MUZIKORE ROME

Fillimi i procesit të vendosjes së “Ciganëve” në qytetet e mëdha të Perandorisë Ruse ishte ngushtë e lidhur me “koret Cigane”. Një kor i parë i tillë i përzier (burra dhe gra) ishte krijuar nga Konti Aleksei Orlov në vitin 1775, në pronën e tij në Pushkino, afër Moskës. Dirigjent ishte Ivan Sokolov (i trashëguar nga nipi i tij Ilia Sokolov), dhe anëtarët e korit ishin bujkrobër. Në fillim të shekullit të 19-të anëtarët e korit ishin liruar nga bujkrobëria dhe u shpërngulën të jetojnë dhe punojnë në Moskë. Në vitin 1812, ata përgatitën donacione të mëdha për nevojat e ushtrisë gjatë luftës kundër Napoleonit, një pjesë e tyre ishin vullnetarë dhe morën pjesë në aksione ushtarake (për shembull në betejën e Borodinos).

Kori romë i Kontit Orlov ishte shumë i famshëm në mesin e aristokracisë ruse. Koret tjera të ngjashme u themeluan, dhe shumë gjenerata të muzikantëve të famshëm “Ciganë” u zhvilluan. Muzikantët “Ciganë” filluan të shpërngulën në Moskë, dhe më pas në Shën Petersburg dhe

në qytetet e tjera të mëdha. Në Moskë, prej vitit 1807 deri në mesin e shekullit të 19-të, muzikantët “Ciganë” gëzonin një lloj të vetë-qeverisjes – ata zgjidhnin “burmistr-in” (prefektin) e tyre, i cili ishte përgjegjës ndaj administratës komunale për rrethimin e taksave (romët ishin regjistruar si “meshchane”), mbante kontakte me autoritetet, zgjidhte konflikte të vogla brenda komunitetit etj.

Pas disa gjeneratave muzikantët dhe aktorët romë në qytetet e mëdha (kryesisht Moskë dhe Shën Petersburg) u bënë shtresë e veçantë sociale (madje të ndarë deri në një shkallë nga romët tjerë), dhe përbënin dinastitë e famshme të artistëve, siç ishin familjet Sokolov, Shishkin, Panin, Khlebnikov, Dulkevich, Pankov, me një pozitë të lartë shoqërore. Muzikantët romë takoheshin rregullisht me regjionet më të larta në Perandorinë Ruse – aristokracinë, tregtarët e pasur, poetët e famshëm, shkrimtarët, muzikantët, etj. Madje ekzistonin martesat e përziera me shoqërinë e lartë: Feodor Tolstoy, (një kushërri i afërt i shkrimtarit Lev Tolstoy), vëllai i shkrimtarit Sergei Tolstoy dhe djali i tij Lev L. Tolstoy, Princi F. P. Masalskii, Princi Witgenstein, milioneri nga Ural

minues së “Ciganët” kishin prejardhjen nga Egjipti. Romëve që u vendosën aty iu dhuruan toka prej 9,902 “desetini” (1 desetina = 1.1 ha). Mirëpo, rreth 800 familje romë në Bessarabia vazhduan mënyrën e tyre nomade të jetesës, përkundër faktit se iu kishin dhuruar toka me më shumë se 11,000 desetini në jug. [III. 8]

Në fillimi romët u vendosën si fshatarë shtetëror, të cilët sidoqoftë, sikurse kolonistët e mbetur, kishin privilegje shtesë– ishin të liruar nga disa obligime ushtarake, iu dhuruan tokat falas, u furnizuan me inventar bujqësor, subvencione shtetërore, koncesione taimore, iu dha mundësia e regjistrimit në pronë më të lartë, e drejta për të udhëhequr tregjet e tyre, privilegji i përdorimit të disa burimeve natyrore etj. Shteti investoi fonde të konsiderueshme për t’iu mundësuar banorëve të rinj fillimin e jetës së tyre në Budzhak, përfshirë romët në Faraonovka dhe Kair.

Mirëpo, çështjet në mesin e kolonistëve të etnive të ndryshme u përballën me vështirësi dhe relativisht shpejt nevojiteshin ndryshimet e reja në statusin e tyre. Në vitin 1836 popullatat e disa fshatrave me kolonistë shtetëror ishin përfshirë në Ushtrinë Kozake të Danubit. Ky status i ri nënkuptonte pri-

vilegje të reja shtesa civile dhe mbi të gjitha ekonomike, në shkëmbim me disa obligime ushtarake. Këto ndryshime gjithashtu patën ndikim te romët dhe më një dekret suprem special të nxjerrë nga Nicolai I me 29 maj, 1839, 1,538 Romë, burra dhe gra nga Faraonovka dhe Kair, së bashku me rreth 1,600 romë nomadë nga Bessarabia u regjistruan në Ushtrinë Kozake të Danubit dhe dy fshatrat rome u bënë “stanitsas” Kozake (vendbanime të kozakëve) përkatëse.

Zhvillimi i dy fshatrave rome, Faraonovka dhe Kair, së bashku me vendosjen e mëtejme të “Ciganëve” në regjionet stepore, gjithashtu u përball me probleme të ndryshme. Romët nga këto fshatra deri atëherë kishin pasur një mënyrë nomade ose gjysmë nomade të jetesës dhe nuk kishin aftësi bujqësore. Përveç kësaj, një numër i vështirësive tjera doli në pah: një sistem i ri i bujqësisë stepore, disa vjet thatësi, një administratë e korruptuar, që përvetësonte një pjesë të subvencioneve shtetërore, etj. Shpesh ka spekulime për paaftësinë e romëve të vendosur në Faraonovka dhe Kair për të mbajtur veten përmes bujqësisë; mirëpo, shënimet nga viti 1839 lidhur me pasuritë e romëve nga këto dy fshatra, tregojnë se nuk ka ndonjë dallim substancial në pasurinë e tyre

në krahasim me të vendosurit tjerë në këtë regjion.

BUJKROBËRIT “CIGANË”

Situata e romëve në Bessarabia, të cilët kishin qenë skllëvër të fisnikërisë dhe manastireve në të kaluarën në Principatën e Moldavisë, ishte goxha ndryshe. Në Rregulloret e Përkohshme për Bessarabinë, të miratuar në vitin 1818, privilegjet e Boyars nga Principata e Moldavisë (tani e referuar si “pomeshchiki” – klasa e pronarëve të tokave) dhe privilegjet e manastireve, përfshirë pronësinë private të skllëvërve “Ciganë” u mbajtën. Situata e romëve, që u përkisnin pronarëve të tokave, ishte zgjidhur në vitin 1828 përmes dekretit të Car Nicolai I, përmes së cilit skllëvërit “Ciganë” u liruan, morën të drejtat civile dhe statusin e bujkrobërve të personave privatë ose manastireve.

Gradualisht statusi i bujkrobërve “Ciganë” filloi të ndryshojë. Disa ikën nga pronarët e tyre dhe u regjistruan si fshatarë shtetëror (më së shpeshti romët nomadë), që shpiu në një situatë goxha të ndërlikuar, që kërkonte zgjidhje radikale. Në vitin 1847 Perandori Nicolai

Nechaev, Anenkov, pronari i pasur i tokave, Ledwik, botuesi i "Borsovie vedomosti", dhe të tjerët, u martuan me vajza rome.

Performansat e para të plotë "Cigane" nga muzikantët dhe aktorët "Ciganë" u vënë në skenë kah fundi i shekullit të 19-të. Me 20 mars, 1888, komedia muzikore "Chave adro vasha" (Fëmijët në pyll) ishte performuar në Teatrin Malyi në Shën Petersburg. Muzika, kryesisht me këngë dhe romanca "Cigane", ishte një aranzhim i Nikolai Shishkin. Interpretimi vazhdimisht ishte shfaqur deri në vitin 1906. Në vitin 1892 u shfaq premiera e operetës së re të N. Shishkin "Jeta Cigane".

III. 11



III. 12

Kori para-revolucionar i "Ciganëve".

(nga Lemon, Alaina (2000) Në mes të dy zjarreve. Durham / London: Duke, f. 45)

I nënshkroi një dekret përmes së cilit pronarët e tokave në Bessarabia ndaloheshin të rimarrin të drejtat e pronësisë ndaj "Ciganëve", të cilët kishin ikur nga ta. Një dekret i ri ishte nxjerrë në të njëjtin vit, sipas të cilit "Ciganët" nga Bessarabia dhe regjioni i Novorosiisk më status të paqartë, mund të regjistroheshin si "meshchane". Sipas logjikës së këtyre dy dekreteve, bujkrobërve romë iu dhurua mundësia tërësisht ligjore t'i braktisnin pronarët e tyre dhe të regjistroheshin në nivel më të lartë.

"CIGANËT" PAS REFORMËS SË VITIT 1861

Në vitin 1861, krahas manifestit të Carit Aleksander II për lirin e bujkrobërve dhe shfuqizimin e bujkrobërisë, u themelua një komision për përpilimin e një projekti me aktivitetet për rregullimin dhe përmirësimin e mënyrës së jetesës të "Ciganëve", që në përgjithësi u bën pjesë e fshatarësisë. Komisioni nuk arriti ndonjë rezultat dhe në fund u shpërnd.

Ushtria kozake e Danubit u shpërnd në vitin 1868 dhe pjesëtarëve romë iu dhanë toka fjalas. Romët në Faraonovka vazhduan të jetonin në fshat, por shumica e romëve në Kair shitën tokat e tyre (rreth

190 ngastra) dhe u kthyen në vendbanimet e tyre të vjetra (në pyjet në veri të Kishinev), në zanatet e tyre tradicionale (prodhimi i të mirave nga druri) dhe në mënyrën e tyre gjysmë nomade të jetesës. Në vitin 1877 në Faraonovka ekzistonin 1,039 Romë, 150 Moldav dhe 103 Ukrainas, ndërsa në Kair në atë kohë vetëm një e treta e popullsisë ishin romë.

Ndryshe nga provincat tjera në Perandorinë Ruse, në Bessarabia bujkrobërit "Ciganë"-, pas fitimit të lirisë së tyre nga bujkrobëria, nuk morën tokë. Për më tepër, ata ishin të obliguar të vazhdonin me pagimin e obligimeve të tyre ndaj pronarëve të mëhershëm për dy vitet e ardhshme. Pas asaj kohe, bujkrobërit romë si dhe fshatarët shtetëror romë kryesisht u regjistruan si "meshchane" në qytezat e Bessarabias. Por kjo nuk nënkuptonte kalimin drejt një mënyre të vendosur të jetesës.

Në këtë periudhë, politikës shtetërore ndaj "Ciganëve" në Perandorinë Ruse i erdhi fund dhe deri në Revolucionin e Tetorit në vitin 1917 ata nuk i nënshtroheshin legjislacionit special apo akteve administrative. Përjashtimi i vetëm ishte përmendja e "Ciganëve" në rregulloret për lëshimin e pasaportave të vitit 1880. Sipas këtyre rregulloreve "Ciganët" e regjistruar në pronën fsha-

tare mund ti merrnin pasaportat vetëm me lejen e autoriteteve lokale, dhe vetëm për një anëtar të familjes. Ideja ishte që të kufizohej mënyra e tyre nomade e jetesës. Ky kufizim nuk ishte i vlefshëm për "Ciganët" e regjistruar në pronat tregtare dhe "meshchane", të cilët mund të udhëtonin lirshëm bashkë me familjet e tyre. Por në praktikë këto masa administrative kishin rezultatin e njëjtë, sikurse të gjitha politikat e mëparshme të Perandorisë Ruse në përpjekjet për kufizimin e mënyrës nomade të jetesës së "Ciganëve": ato ishin një dështim total.

Në fakt e tërë politika shtetërore e Perandorisë Ruse ndaj "Ciganëve" gjatë më tepër se një shekulli mund të shihet si përsëritje e vazhdueshme e masave, që duhet ti shtynin ata (mirëpo jo me dhunë) të bëheshin subjekte "normale" të Perandorisë dhe taksapagues. Sidoqoftë, këto masa kurrë nuk ishin në fokusin e politikës së përgjithshme shtetërore, por disi në periferi të saj. "Ciganët" ishin një përbindje e parëndësishme (më pak se një përbindje) e popullsisë së tërësishme të Perandorisë, kështu që atyre u kushtohej vëmendje më tepër për shkak të tipareve të tyre ekzotike, vështruar nga popullsia lokale, sesa për shkak se konsideroheshin një qëllim i rëndësishëm i politikës shtetërore.

DEMOGRAFIA

III.13

Edhe pse demografia zakonisht ka mungesë të saktësisë në rastin e romëve, proporcioni i romëve në popullsinë e përgjithshme të Perandorisë Ruse më së miri shihet në statistika. Në vitin 1834 nga 60 milion banorë të Perandorisë Ruse, ishin 48,247 “Ciganë”, ku 8,000 prej tyre jetonin në qytetet dhe 18,738 në Bessarabia. Rreth një çerek shekulli më vonë numrat janë të ngjashëm (1862), kur “Ciganët” në Perandorinë Ruse mendoheshin të jenë përafërsisht 50,000, 17,000-18,000 prej tyre në Bessarabia, dhe 7,500-8,000 në Krimea. Të dhënat nga regjistrimi i vitit 1897 duken të jenë relativisht të sakta, kur popullsia në Perandorinë

Ruse ishte rreth 125.7 milion, dhe “Ciganët” zyrtarisht ishin 44,584, 38,031 prej tyre banorë rural dhe 6,551 jetonin në qytete. Shpërndarja gjeografike ishte e pabarabartë, 8,636 “Ciganë” jetonin në Bessarabia, 1,056 në Poloni, 1,750 në Latvi dhe Estoni, 3,003 në Lituani dhe Bjellorusi, 3,177 në Rusinë e vogël, 14,300 në Novorussia, 2,138 në Vollgën jugore, 1,080 Vollgën veriore, 2,021 në Rusinë veriore, 2,784 në Rusinë qendrore, 3,223 në regjionin qendror Chernozem, 1,433 në Krimea, 2,829 në Kaukazin verior, 212 në Transkaukaz, 628 në Azinë qendrore, 6,238 në Siberi dhe 143 në stepe në lindje të Vollgës.

PËRFUNDIM

Pasqyra e përgjithshme e romëve në Perandorinë Ruse në prag të Revolucionit të Tetorit të vitit 1917 është goxha e ndryshuar. Shumica e romëve vazhduan të jetonin mënyrën e tyre tradicionale të jetesës (gjysmë nomade, duke banuar me qira gjatë dimrit, dhe shumë shpesh me regjistrim të rrejtshëm të taksës në regjionet rurale). Një pjesë relativisht e vogël e tyre ishte vendosur në fshatrat e Rusisë veri-perëndimore, si dhe në Ukrainë, pa braktisur në tërësi mënyrën e tyre gjysmë nomade të jetesës dhe zejet tradicionale. Proceset e vendosjes vazhduan të realizohen në mënyrë aktive edhe në Bessarabia. Pjesa e tretë relativisht e vogël e romëve ishte vendosur në qyteza, të regjistruar

kryesisht si tregtarë dhe “meshchane”, disa prej tyre goxha të pasur, pasi që ishin bërë tregtarë ose pronarë të ndërmarrjeve. Muzikantët dhe aktorët romë ishin të afërt me ta në aspektin social. [Illi. 11, 12]

Nuk ka dyshim se integrimi shoqëror i romëve në Perandorinë Ruse ishte shumë më i suksesshëm sesa i bashkardhetarëve të tyre në Ballkan, e aq më shumë në Evropën qendrore dhe perëndimore gjatë periudhës së njëjtë. Në literaturë janë ofruar interpretime të ndryshme për këtë pozitë të veçantë shoqërore të zënë nga romët në Perandorinë Ruse, por prapëseprapë asnjëra prej tyre nuk i ka kushtuar vëmendje shpjegimit të shkurtë dhe shumë preciz të dhënë nga N. Shchiber në fund të shekullit të 19-të: “Sipas legjislacionit tonë Ciganët kurrë

nuk janë trajtuar ndaras si një fis specifik, as si një rang specifik shoqëror, dhe nuk janë përfshirë në kategorinë e ‘inorodtsi’ (qytetarë të huaj).”

Për këtë arsye, si një tërësi, politika e Perandorisë Ruse ndaj “Ciganëve i ishte nënshtruar qëllimit për bërjen e tyre subjekte të pranuar nga Perandoria, që gëzonin të drejtat e plota civile, por që gjithashtu përmbushnin obligimet e tyre civile. Mbi të gjitha kjo ishte një politikë mbizotëruese: “Ciganët” shiheshin si një pjesë e pandarë e shoqërisë, dhe kështu i nënshtroheshin ligjeve të përgjithshme të vendit. Në rastet kur ishte nevoja për një politikë të posaçme ndaj “Ciganëve”, qëllimi ishte të tejkaloheshin ndarja e tyre nga shoqëria, që nuk do të thoshte se ata do të asimiloheshin.

Bibliografia

Barannikov, Aleksei P. (1931) Tsygany SSSR. Kratkii istoriko-etnograficheskii ocherk. Moskva | **Bessonov, N. / Demeter, N. G. / Kutentkov, V. (2000)** Istoriya tsygan. Novyi vsglyad. Voronezh: Rossiyskaya Akademiya Nauk | **Crowe, David (1995)** A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia. London / New York: Tauris | **German, Aleksander V. (1930)** Bibliografiya o tsyganach. Ukasatel knig i statei s 1780 do 1930 gg. Moskva | **Kalinin, Valdemar (2003)** Zagadki baltiiskikh tsygan (Rossiya, Estoniya, Litva, Latviya, Polska). Vitebsk | **Kenrick, Donald / Taylor, Gillian (1998)** Historical Dictionary of the Gypsies (Romanies). Lanham: Scarecrow | **Keppen, P. (1861)** Khronologicheskii ukasatel materialov dlia istorii inorodtsev Evropeiskoi Rosii. Sankt-Petersburg | **Lundgren, Gunilla / Taikon, Alyosha (2003)** From Coppersmith to nurse. Hatfield: University of Hertfordshire Press | **Marushiakova, Elena / Popov, Veselin (2003)** Social Position of the Gypsies in Contemporary Russia and the Countries of the former USSR. In: Dvorák, Tomáš (ed.) Mily Bore ... Profesoru Ctiboru Necasovi k jeho sedmdesátým narozeninám venuj í prátele, kolegové a záci. Brno: Historický ústav AV ČR, pp. 237-244 | **Marushiakova, E. / Mischek, U. / Popov, V. / Streck B. (2005)** Dienstleistungsnomadismus am Schwarzen Meer. Zigeunergruppen zwischen Symbiose und Dissidenz. Halle-Wittenberg



© Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjete, elektronike (CD-Rom, Internet, etj.) ose mekanike, përfshirë fotokopjimi, incizimi apo sistemi i ruajtjes ose mbajtjes së informatave, pa lejen paraprake me shkrim nga Divizioni i Botimit, Drejtoria e Komunikimit (F-67075, Strasbourg cedex ose publishing@coe.int)



PROJEKT PËR EDUKIMIN E
FËMIJËVE ROMË NË EVROPË
<http://www.coe.int/education/roms>

[romani] PROJECT <http://romani.uni-graz.at/romani>